	POLICIA E SHETITIT	Titulli: Procedura standarde: “Për zhvillimin e fazave të vlerësimit dhe testimit për pranimin në rolin zbatues dhe rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit”.		
Data e miratimit : Urdhër nr. 609 dt. 16.4. 2026		Numër:	Nr. Fq: 34	Rishikimi fundit:
Referencë: <ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 69–77. - Rregullorja e Policisë së Shtetit nr. 112, datë 24.02.2025, neni 70. - Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 129, datë 01.08.2025, “Për përcaktimin e moshës për kategoritë e pranimin në rolet policore”. - Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 18, datë 04.02.2026, “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për pranimet në rolin zbatues në Policinë e Shtetit”. - Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 19, datë 04.02.2026, “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për pranimet në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit”. 		Shpërndarë: Gjithë strukturave në Policinë e Shtetit.		Fusha: Menaxhimi i burimeve njerëzore ne Policinë e Shtetit

I. POLITIKA

Kjo procedurë mbështet parimet e profesionalizmit, meritokracisë, transparencë, integritetit dhe paanshmërisë në procesin e pranimit të kandidatëve në Policinë e Shtetit. Procesi synon garantimin e standardeve më të larta në përzgjedhjen e personelit të ri, të aftë fizikisht, profesionalisht dhe me integritet të plotë moral.

II. QËLLIMI

Kjo procedurë ka për qëllim:

- përcaktimin e mënyrës së organizimit të pranimeve në rolin zbatues dhe rolin e parë drejtues;
- unifikimin e standardeve dhe fazave të konkurrimit;
- përcaktimin e kompetencave institucionale;
- garantimin e një procesi transparent, të dokumentuar, të drejtë dhe gjithëpërfshirës;
- sigurimin e kandidatëve me performancë të lartë, integritet moral dhe aftësi të përputhshme me kërkesat e punës policore.

II. PËRKUFIZIME

1. **Policia e Shtetit** – Institucioni shtetëror përgjegjës për sigurimin e rendit dhe zbatimin e ligjit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. **Roli zbatues** – Funksion i strukturave policore ku punonjësi kryen detyra operative dhe kontrolli mbi zbatimin e ligjit në terren, pa kompetenca drejtuesi.
3. **Roli i parë drejtues** – Funksion i punonjësve të Policisë së Shtetit me detyra drejtimi të drejtpërdrejta, duke përfshirë planifikim, koordinim dhe mbikëqyrje të stafit të varësisë.
4. **Aplikant** – Person që paraqet dokumentacionin e kërkuar dhe plotëson kriteret paraprake për të marrë pjesë në procesin e pranimit në Policinë e Shtetit.
5. **Konkurrimi** – Procesi i organizuar për përzgjedhjen e kandidatëve, i bazuar në kritere objektive dhe teste standarde, që garanton meritokraci dhe transparencë.
6. **Testimi administrativ** – Vlerësim i dokumentacionit dhe përvojës së kandidatëve, duke përfshirë arsimimin, përvojën profesionale dhe trajnimet e kryera.
7. **Testimi me shkrim** – Provë që mat njohuritë teorike dhe aftësitë intelektuale të aplikantëve, përputhshmërinë me fushën e shërbimit dhe kategorinë e pranimit.
8. **Testimi fizik** – Vlerësim i aftësive psikomotore dhe kondicionit fizik të kandidatëve, duke përfshirë shpejtësinë, forcën, shkathhtësinë dhe koordinimin.
9. **Testimi psikologjik** – Vlerësim i kapaciteteve mendore, qëndrueshmërisë emocionale, aftësive të marrjes së vendimeve dhe integritetit të kandidatëve.
10. **Intervista me gojë** – Bisedë strukturore ku komisioni vlerëson aftësitë komunikative, motivimin, përputhshmërinë me vlerat institucionale dhe qasjen profesionale të kandidatëve.
11. **Komisioni i pranimit** – Grup ekspertësh të përzgjedhur nga struktura kompetente, përgjegjës për zhvillimin e testeve dhe vlerësimin e kandidatëve.

12. **Komisioni i kontrollit shëndetësor** – Grup mjekësh që kryen ekzaminimet mjekësore dhe psikologjike për të përcaktuar aftësinë e kandidatëve për t'u pranuar në Policinë e Shtetit.
13. **Skualifikimi** – Situatë ku aplikanti nuk plotëson kriteret e pranimit ose ka rezultate negative në fazat e testimit, duke rezultuar në përjashtim nga procesi i konkurrimit.
14. **Ankimi** – E drejta e kandidatëve për të kundërshtuar vendimet e marrë gjatë procesit të pranimit, duke u shqyrtuar nga komisioni përkatës sipas rregullave të përcaktuara.
15. **Drejtoria e Burimeve Njerëzore** – Struktura përgjegjëse për koordinimin, administrimin e dokumentacionit, shpalljen e aplikimeve dhe publikimin e rezultateve.
16. **Akademia e Sigurisë** – Institucioni që siguron trajnim fillestar, stafin mbikëqyrës dhe ambientet për zhvillimin e testeve dhe trajnimeve.
17. **Spektori i Profilaksisë-Mjekimit** – Struktura që administron kontrollin shëndetësor dhe vendos për aftësinë mjekësore të aplikantëve.
18. **Vertetimi i besueshmëria** – Vlerësimi i integritetit, historikut dhe përshtatshmërisë ligjore të kandidatëve për t'u pranuar në Policinë e Shtetit.
19. **Vlera minimale për kalim** – Rezultati më i ulët i pranueshëm në çdo test (administrativ, me shkrim, fizik, psikologjik) që lejon kalimin në fazën pasuese të procesit.

IV. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo procedurë zbatohet për pranimin e kandidatëve në rolet policore të Policisë së Shtetit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe aktet nënligjore në fuqi. Pranimi kryhet përmes konkurrimit, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Pranimi në rolin zbatues

Në rolin zbatues pranohen:

1. Shtetas të Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë.
2. Punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë.

Në këtë kategori përfshihen:

- a) ushtarët profesionistë dhe nënoficerët e Forcave të Armatosura;
- b) punonjësit e nivelit bazë të Gardës së Republikës;
- c) punonjësit e rolit bazë të Policisë së Burgjeve.

b) Pranimi në rolin e parë drejtues

Në rolin e parë drejtues pranohen:

1. Punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë, që kanë përfunduar arsimin e lartë, si:
 - a) oficerët me grada të ulëta të Forcave të Armatosura;
 - b) punonjësit e nivelit të mesëm të Gardës së Republikës;
 - c) punonjësit e rolit të mesëm të Policisë së Burgjeve.

2. Shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, në profilet e parashikuara në Rregulloren e Policisë së Shtetit.
3. shtetas që janë pjesë e Policisë Gjyqësore
4. shtetas që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë.

V. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Kjo procedurë detyron të gjitha strukturat që marrin pjesë në organizimin, koordinimin dhe zbatimin e procesit të pranimit në rolin zbatues dhe në rolin e parë drejtues. Struktura përgjegjëse sipas kompetencave janë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

- Udhëheq, miraton dhe mbikëqyr zbatimin e të gjitha fazave të procesit.

2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore

- a) Harton urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe publikon thirrjet për aplikim.
- b) Administron aplikimet e shtetasve që shprehin interesin për konkurrim nga institucionet e tjera të sigurisë.
- c) Shqyrton paraprakisht dokumentacionin e aplikantëve.
- d) Koordinon dhe monitoron gjithë procesin e pranimit.
- e) Publikon njoftimet e komisioneve të pranimit dhe ankimimit.

3. Akademia e Sigurisë

- a) Menaxhon procesin e konkurrimit për kategorinë e pranimit të shtetasve të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, dhe aplikojnë nëpërmjet portalit U-albania.
- b) Siguron anëtarët e komisioneve dhe stafin mbikëqyrës.
- c) Siguron sekretarin për regjistrimin dhe verifikimin e aplikantëve.
- d) Siguron ambientet për zhvillimin e testimit.
- e) Publikon njoftimet e komisioneve të vlerësimit.
- f) Përcakton përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e programit të formimit, bazuar në vlerësimin e formimit arsimor dhe të kualifikimeve të kandidatëve.

5. Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor

- a) Nxjerr urdhërin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e pyetjeve të testit me shkrim, testit psikologjik dhe intervistës me gojë.
- b) Administron bankën e pyetjeve dhe e vë në dispozicion të komisioneve.
- c) Publikon referencat e bankës së pyetjeve për orientimin e aplikantëve që do të nënshtrohen procesit të testimit.

6. Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Komisarariatet e Policisë

- a) Afishojnë njoftimet zyrtare në territor.
- b) Administron aplikimet e shtetasve që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë.
- c) Verifikojnë të dhënat e besueshmërisë së kandidatëve në nivel vendor.
- d) Përfaqësohen në komisionet e apelimit, sipas rastit.

7. Instituti i Policisë Shkencore

- a) Merret me marrjen dhe administrimin e gjurmëve daktiloskopike të aplikantëve.
- b) Verifikon të dhënat biometrike sipas procedurave standarde.

8. Sektori i Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

- a) Siguron transparencë dhe komunikim publik gjatë procesit.
- b) Publikon njoftime, afishe dhe rezultatet paraprake dhe përfundimtare.

9. Komisionet e pranimit, vlerësimit dhe ankimit

- a) Verifikojnë dokumentacionin dhe kriteret ligjore të aplikantëve.
- b) Zhvillojnë kontrollin shëndetësor, testin me shkrim, testi fizik, intervistën me gojë dhe testin psikologjik.
- c) Vlerësojnë me pikë dhe rendisin aplikantët sipas rendit zbritës.
- d) Shqyrtojnë ankesat dhe japin vendimet përfundimtare.

10. Komisioni i Kontrollit Shëndetësor

- a) organizimin dhe realizimin e kontrolleve dhe ekzaminimeve mjekësore e psikologjike të aplikantëve;
- b) përcaktimin e institucioneve ku kryhen ekzaminimet specifike, kur është e nevojshme.

VI. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN NË POLICINË E SHTETIT

Procedura e pranimit në Policinë e Shtetit zhvillohet nëpërmjet hapave të mëposhtëm, të detyrueshëm dhe të standardizuar:

1. Shpallja e fazës së aplikimeve

Publikimi i njoftimit për pranimin e kandidatëve në Policinë e Shtetit, sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme.

2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit

Kandidatët paraqesin dokumentacionin e kërkuar, duke respektuar kriteret ligjore dhe

rregulloret përkatëse.

3. Administrimi dhe verifikimi paraprak i dokumentacionit

- a) Vlerësimi i plotësisë dhe vlefshmërisë së dokumenteve të dorëzuara.
- b) Kontrolli i përputhshmërisë me kushtet ligjore dhe kriteret e pranimit.

4. Kontrolli shëndetësor

Kandidatët që kalojnë fazat paraprake nënshtrohen kontrollit shëndetësor sipas standardeve mjekësore të Policisë së Shtetit, të detyrueshëm për pranimin në shërbim.

5. Testimet dhe vlerësimi i kandidatëve

- 5.1 Vlerësimi administrativ
- 5.2 Testimi me shkrim
- 5.3 Testimi fizik
- 5.4 Testimi psikologjik

6. Verifikimi i besueshmërisë

Vlerësimi i besueshmërisë së kandidatëve në përputhje me procedurat ligjore dhe rregulloret e Policisë së Shtetit.

7. Rastet e skualifikimit

Kandidatët që nuk përmbushin kriteret e pranimit ose kanë rezultate negative në procesin e vlerësimit konsiderohen të skualifikuar.

8. Procedura e ankimit

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankimim në lidhje me vendimet e marrë gjatë procesit të pranimit, sipas rregullave të përcaktuara me ligj.

9. Shpallja e rezultateve

Publikimi i rezultateve përfundimtare të procesit të pranimit në Policinë e Shtetit, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara.

10. Dokumentimi dhe arkivimi

- a) Të gjitha dokumentet dhe të dhënat e mbledhura gjatë procesit të pranimit duhet të dokumentohen dhe arkivohen në mënyrë të saktë dhe të sigurt.
- b) Arkivimi kryhet sipas standardeve të Policisë së Shtetit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- c) Dokumentacioni i arkivuar mund të përdoret për referencë në rast të ankimeve, auditimeve ose verifikimeve të mëvonshme.

VI. PROCEDURA E VEPRIMIT SIPAS ROLEVE NË POLICINË E SHTETIT

VI/1. PROCEDURA E KONKURRIMIT PËR ROLIN ZBATUES

A. Shtetasit që kanë përfunduar arsim të mesëm të lartë.

1. Dokumentacioni i aplikantit

Aplikanti paraqet pranë Drejtorive Vendore të Policisë, nëpërmjet strukturave vendore të burimeve njerëzore, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin e aplikimit dhe autorizimin për sigurimin e dokumentacionit;
- b) Formularët e vetëdeklarimit;
- c) Formularin e dekriminalizimit;
- d) Fotokopje të kartës së identitetit;
- e) Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë, me listë notash të noterizuar;
- f) Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit, kategoria “B”;
- g) Certifikatë të gjendjes gjyqësore;
- h) Certifikatë familjare;
- i) Vërtetim nga gjykata;
- j) Vërtetim nga prokuroria;
- k) Vërtetim nga Prokuroria e Posaçme (SPAK);
- l) Raport mjekoligjor;
- m) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim të ndjekjes së arsimit të lartë (nëse disponohet);
- n) Dokument nga institucionet shëndetësore që vërteton se aplikanti nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit përfshin:

- a) Kontrolli shëndetësor i aplikantëve;
- b) Testimi i aftësive fizike;
- c) Testimi me shkrim;
- d) Intervista me gojë;
- e) Testimi psikologjik.

3. Komponentët e vlerësimit dhe pesha në përqindje

- a) Testimi me shkrim: **50%** e vlerësimit të përgjithshëm;
- b) Testimi i aftësive fizike: **30%** e vlerësimit të përgjithshëm;
- c) Intervista me gojë: **20%** e vlerësimit të përgjithshëm;
- d) Testimi psikologjik: kalues/jo kalues.

4. Kalimi në fazën pasuese

Aplikantët kalojnë në fazën pasuese vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses secilën nga fazat,

sipas rendit të përcaktuar për kategorinë përkatëse.

5. Kufizimet e moshës

Mosha minimale dhe maksimale e pranimit për çdo kategori përcaktohet sipas Urdhrit të Ministrisë të Brendshme, për përcaktimin e moshës për kategoritë e pranimit në rolet policore.

6. Zhvillimi i testeve

- a) Pyetjet e testit me shkrim për pranimin në rolin zbatues, hartohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- b) Pyetjet e testit me shkrim për pranimin në rolin e parë drejtues, për aplikantët që pranohen nga institucionet e tjera të sigurisë dhe punonjësit me statusin e policisë gjyqësore, hartohen nga grupi i punës i ngritur me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- c) Testimi i aftësive **fizike, intervistat me gojë dhe testimi psikologjik** zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë procedurë.

B. Punonjësit nga institucionet e tjera të sigurisë

1. Dokumentacioni i aplikantit

Aplikantët nga radhët e punonjësve të rolit zbatues të institucioneve të tjera të sigurisë (Forcat e Armatosura, Garda e Republikës, Policia e Burgjeve) paraqesin pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, dokumentacionin si vijon:

- Dokumentacionin e përcaktuar në kreun VI, pika 4, të Udhëzimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 18, datë 04.02.2026;
- Dokumentacionin shtesë të kërkuar në Urdhrin e Shpalljes të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit për këta aplikantë përfshin këto faza:

- a) Testimi i aftësive fizike;
- b) Testimi psikologjik.

3. Vlerësimi i kandidatëve

Vlerësimi i kandidatëve kryhet në këto komponentë:

- a) Testi i aftësive fizike, i cili vlerëson aftësitë psikomotore, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike dhe koordinimi fizik. Testi fizik ka 100 (njëqind) pikë, dhe pragu minimal i kalimit është 70 (shtatëdhjetë) pikë.
- b) Testi psikologjik, i cili synon të vlerësojë stabilitetin emocional, përshtatshmërinë për detyrën, aftësinë për të përballuar stresin dhe presionin, si dhe integritetin personal e etik. Rezultati i testit psikologjik shënohet me **“kalues” ose “jo kalues”**.

4. Zhvillimi i testimeve

Testimi i aftësive fizike dhe testimi psikologjik zhvillohen në përputhje me Lidhjen 1.2, bashkëlidhur kësaj procedure.

VI/2. PROCEDURA E KONKURRIMIT PËR ROLIN PARË DREJTUES

A. Punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë me arsim të lartë (për rolin e parë drejtues)

1. Dokumentacioni i aplikimit

Aplikantët nga Forcat e Armatosura, Garda e Republikës dhe Policia e Burgjeve paraqesin pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dokumentacionin e përcaktuar në kreun V, pika 5, të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 19, datë 04.02.2026, si dhe dokumentacionin shtesë të përcaktuar në Urdhrin e Shpalljes të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit për këta aplikantë zhvillohet në këto faza:

- a) Testimi i aftësive profesionale;
- b) Testimi psikologjik.

3. Vlerësimi i kandidatëve

3.1. Testi i aftësive profesionale ka 100 pikë dhe pragu minimal i kalimit është **70 (shtatëdhjetë)** pikë.

Testi vlerëson:

- a) njohuritë mbi legjislacionin penal dhe procedurën penale;
- b) njohuritë mbi organizimin dhe funksionimin e Policisë së Shtetit;
- c) standardet etike dhe profesionale;
- d) të drejtat e njeriut.

3.2. Testi psikologjik vlerëson:

- a) stabilitetin emocional;
- b) përshtatshmërinë për detyrën;
- c) aftësinë për të përballuar stresin dhe presionin;
- d) integritetin personal dhe etik.
 - i. Rezultati i testit psikologjik shënohet kalues / jo kalues.
 - ii. Kandidatët që nuk kalojnë me sukses njërin prej testeve s'kualifikohen nga procedura e mëtejshme e pranimit.
 - iii. Aplikantët kalojnë në fazën pasuese vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses secilën prej fazave, sipas rendit të përcaktuar për kategorinë përkatëse.

4. Zhvillimi i testimeve

4.1. Testi i aftësive profesionale dhe testi psikologjik hartohen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, në bashkëpunim me Komisionin e Pranimi/Vlerësimit, duke shfrytëzuar bankën e pyetjeve.

4.2. Testimi i aftësive profesionale dhe testimi psikologjik zhvillohet në përputhje me **Lidhjet 1 dhe 2**, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e kësaj procedure.

B. Shtetasit me ciklin e dytë të studimeve, që aplikojnë në rolin e parë drejtues

1. Dokumentacioni i aplikimit

Aplikanti paraqitet pranë drejtorisë vendore të Policisë së Shtetit, në vendbanimin e tij, dhe dorëzon dokumentacionin e përcaktuar në kreun VI, pika 16, të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 19, datë 04.02.2026, si edhe dokumentacionin shtesë të përcaktuar në Urdhrin e Shpalljes së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit për këtë kategori aplikantësh zhvillohet në këto faza:

- a) Vlerësimi administrativ
- b) Testimi fizik
- c) Intervista me gojë
- d) Testi psikologjik

3. Vlerësimi i kandidatëve kryhet sipas komponentëve të mëposhtëm:

- a) Nota mesatare e arsimit të lartë (50% e vlerësimit të përgjithshëm). Vlerësimi llogaritet me 5 (pesë) pikë për çdo njësi të notës mesatare. P.sh.: nota mesatare $8 \times 5 = 40$ pikë.
- b) Testimi fizik (30% e vlerësimit të përgjithshëm).
- c) Intervista me gojë (20% e vlerësimit të përgjithshëm).
- d) Testi psikologjik, mbi bazën e raportit vlerësues psikologjik (kalues/jo kalues).

Aplikantët kalojnë në fazën pasuese vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses secilën prej fazave, sipas rendit të përcaktuar për kategorinë përkatëse.

C. Punonjësit e Policisë Gjyqësore që Aplikojnë për Rolin e Parë Drejtues

1. Dokumentacioni i aplikimit

Aplikanti paraqet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dokumentacionin e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, si dhe në urdhrin e shpalljes së aplikimeve, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit për këtë kategori aplikantësh zhvillohet në këto faza:

- a) Testimi i aftësive profesionale;
- b) Testimi psikologjik.

3. Komponentët e vlerësimit

Fazat e vlerësimit për kandidatët që aplikojnë për pranimin në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit, përfshijnë:

3.1. Testi i aftësive profesionale

- a) Testi i aftësive profesionale ka 100 (njëqind) pikë,
- b) Pragu minimal i kalimit është 70 (shtatëdhjetë) pikë.

3.1.1. Testi vlerëson njohuritë mbi:

- a) legjislacionin penal dhe procedurën penale;
- b) organizimin dhe funksionimin e Policisë së Shtetit;
- c) standardet etike dhe profesionale;
- d) të drejtat e njeriut.

3.2. Testi psikologjik

Testi psikologjik synon të vlerësojë:

- a) stabilitetin emocional;
- b) përshtatshmërinë për detyrën;
- c) aftësinë për të përballuar stresin dhe presionin;
- d) integritetin personal dhe etik.

Rezultati i testit psikologjik shënohet me “kalues” / “jo kalues”.

4. Kalimi në fazën pasuese

Aplikantët kualifikohen për fazën pasuese vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses secilën prej fazave të testimit, sipas rendit të përcaktuar për kategorinë përkatëse.

5. Testi i aftësive profesionale

Testi i aftësive profesionale dhe testi psikologjik hartohen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, në bashkëpunim me Komisionin e Pranimit/Vlerësimit, duke u bazuar në bankën e pyetjeve.

6. Testimi i aftësive profesionale dhe testimi psikologjik

Testimi i aftësive profesionale dhe testimi psikologjik zhvillohen në përputhje me Lidhjen 1.2, bashkëlidhur kësaj procedure.

D. Shtetas që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë

1. Dokumentacioni i aplikimit

Aplikimi kryhet në portalin U-Albania, nëpërmjet formularit online të aplikimit, duke përzgjedhur programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”.

Komisioni i Pranimit shkarkon nga portali U-Albania listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”.Lista e aplikantëve që kanë aplikuar për këtë program studimi afishohet në ambientet e Akademia e Sigurisë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Policia e Shtetit dhe të Akademia e Sigurisë.

Aplikantët paraqiten për regjistrim dhe dorëzim të dokumentacionit fillestar, i cili përfshin:

- Kërkesën model-tip për regjistrim;
- Formularin e aplikimit për punësim në strukturat e Policia e Shtetit;
- Formularin e vetëdeklarimit;
- Formularin e dekriminalizimit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Certifikatë familjare;
- Dokumentacionin shtesë të përcaktuar në urdhrin e shpalljes së Drejtorit të Përgjithshëm të Policia e Shtetit.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit për këtë kategori aplikantësh zhvillohet në fazat e mëposhtme:

- Vlerësimi administrativ;
- Testimi fizik;
- Intervista me gojë;
- Testi psikologjik.

3. Vlerësimi i kandidatëve

Vlerësimi i kandidatëve kryhet mbi bazën e komponentëve të mëposhtëm:

a) Nota mesatare e arsimit të mesëm të lartë – përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm.

Vlerësimi llogaritet me 5 (pesë) pikë për çdo njësi të notës mesatare.

Shembull: nota mesatare $8 \times 5 = 40$ pikë.

b) Testimi fizik – përbën 30% të vlerësimit të përgjithshëm.

c) Intervista me gojë – përbën 20% të vlerësimit të përgjithshëm.

ç) Testi psikologjik zhvillohet mbi bazën e raportit të vlerësimit psikologjik dhe klasifikohet si “kalues” ose “jo kalues”.

4. Kontrolli shëndetësor, testimi fizik, testimi psikologjik, intervista me gojë dhe procesi i verifikimit të besueshmërisë zhvillohen në përputhje me Kreun VIII, IX, X, XI, XII dhe XIII të kësaj procedure.

5. Aplikantët kalojnë në fazën pasuese vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses secilën prej fazave të përcaktuara, sipas rendit të tyre.

6. Komisioni i Pranimit publikon në portalin U-Albania listën e aplikantëve fitues, të renditur sipas pikëve në rend zbritës.

E. Punonjës të Policisë së Shtetit të rolit zbatues me arsim të lartë, nëpërmjet konkurrimit

1. Dokumentacioni i aplikantit

Aplikanti paraqet pranë strukturave vendore të burimeve njerëzore në Drejtoritë Vendore të Policisë dokumentacionin e kërkuar në Urdhrin e Shpalljes të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Konkurrimi për pranimin në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në programin e parë të studimit Bachelor për këtë kategori, zhvillohet në të njëjtën kohë me aplikantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe që aplikojnë nëpërmjet portalit U-Albania.

2. Fazat e testimit

Procesi i testimit përfshin këto faza:

- Testimi me shkrim;
- Intervista me gojë.

3. Komponentët e vlerësimit dhe pesha në përqindje

Vlerësimi i kandidatëve kryhet sipas këtyre komponentëve:

- Testimi me shkrim – 60% e vlerësimit të përgjithshëm;
- Intervista me gojë – 40% e vlerësimit të përgjithshëm.

4. Aplikantët kalojnë në fazën pasuese vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses secilën nga fazat, sipas rendit të përcaktuar për kategorinë përkatëse.
5. Hartimi i pyetjeve për testimin me shkrim dhe për intervistën me gojë kryhet nga komisione të përcaktuara me urdhrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe administrohen paraprakisht në bankën e pyetjeve.
6. Testimi me shkrim dhe intervista me gojë zhvillohen në përputhje me përcaktimet e Kreut IX dhe Kreut XI të kësaj procedure.

VII. ADMINISTRIMI DHE VERIFIKIMI PARAPRAK I DOKUMENTACIONIT

1. Strukturat e Burimeve Njerëzore bëjnë verifikimin e dokumentacionit të aplikantëve jo më vonë së 5 dite pune nga data e dorëzimit dhe protokollimit në sekretarinë e institucionit.
2. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit ka të bëjë me plotësimin e kriterëve nga aplikantët, dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar në momentin e aplikimit si dhe plotësimin e formularëve në mënyrën e duhur.
3. Nëse gjate shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton së aplikanti nuk plotëson kriteret e përcaktuara, apo ka mungesë dokumentacioni, ai s'kualifikohet nga procesi i konkurrimit.

4. Aplikanti njoftohet nëpërmjet emailit të evidentuar nga ana e tij në formularin e aplikimit në lidhje me s,kualifikimin dhe arsyet e tij.

VIII. KONTROLLI SHËNDETËSOR

1. Kontrolli shëndetësor kryhet nga Komisioni përkatës i përcaktuar që në momentin e shpalljes së fazës së aplikimeve.
2. Strukturat vendore të Burimeve Njerëzore ku kryhet aplikimi për pranim në Policinë e Shtetit, dërgojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, listën e aplikantëve që plotësojnë kriteret për të vazhduar procesin e konkurrimit dhe do t'i nënshtrohen procesit të kontrollit shëndetësor.
3. Drejtorja e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Sektorin e Profilaksisë - Mjekimit, njofton aplikantët për orën, datën dhe vendin ku do të kryhet kontrolli shëndetësor.

4. Kriteret e përgjithshme për aplikantët

- a. Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe nuk duhet të jenë bartës të sëmundjeve kronike apo të sëmundjeve të cilat mund të përsëriten, si dhe nuk duhet të jenë përdorues të lëndëve narkotike. **Aplikantët duhet të paraqesin Anamnesis vitae nga mjeku i familjes, si dëshmi e gjendjes së tyre të përgjithshme shëndetësore.**
- b. Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet normal të organeve të brendshme në Hematologji, Onkologji, Gastroenterologji, Nefrologji, Endokrinologji, Imunologji, Reumatologji, Angiologji,

5. Kriteret dermatologjike

- Lëkura dhe flokët e aplikantëve për rekrutim nuk duhet të paraqesin probleme, të mos kenë njolla apo përbërje tumori që i përkasin lëkurës dhe janë të dukshme.

6. Kriteret e kirurgjisë së përgjithshme

- Aplikantët duhet të kenë shëndet të plotë, të mos kenë funksione të prishura, të fituara apo të trashëguara, të mos kenë djegie, shenja të mëdha. Gjithashtu, nga aplikanti duhet të bëhet i ditur çdo operacion të mëparshëm që ka kryer.

7. Kriteret e ortopedi - traumatologjisë

- Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë, të mos kenë anormali të këtij sistemi dhe nuk duhet të kenë bërë operacione që ndikojnë në funksionin e lëvizjeve.

8. Kriteret për sistemin urogenital

- Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë, të mos kenë bërë operacione dhe të mos kenë anomali të sistemit urogenital. Por mund të pranohen ata aplikantë, të cilët me anë të mjekimit apo operacionit të testit, hidrocele, varikocel dhe hipostadi janë shëruar plotësisht. Gjithashtu, mund të pranohen aplikantët, të cilët me anë operacioni kanë mangësi të një testi, por që testi tjetër është i shëndoshë.

9. Kriteria okulistike

- a. Çdo aplikant duhet të ketë shikim 7/10 në çdo sy, pa syze. Çdo aplikant duhet të jetë në gjendje të dallojë ngjyrat bazë, të përcaktuara me anë të një testi përkatës dhe të ketë fushën vizive normal.
- b. Aplikantët duhet të kenë shëndet të plotë, nuk duhet të kenë kryer asnjë operacion të syve, të mos kenë shenja plagë rreth syve dhe kapakëve të syve.

10. Kriteria kardiologjike

- Në drejtim të zemrës dhe të sistemit të qarkullimit të gjakut, aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë. Për këtë, duhet të paraqitet prej aplikantëve EKG dhe ECHO e zemrës.

11. Kriteria për sëmundje infektive

- a) Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe të mos jenë bartës të ndonjë sëmundje ngjitëse.
- b) Nuk do të pranohen ata aplikantë të cilët kanë antigen pozitiv (aktiv ose jo aktiv). Nëse se kursanti, gjatë periudhës së studimit del me Hbs pozitiv, largohet nga Akademia e Sigurisë.
- c) Nuk do të pranohen as ata aplikantë, të cilët janë bartës të hepatitit C apo virusit HIV dhe që mund të kenë në vijueshmëri shenja përmirësimi.

12. Kriteria për sëmundje të frymëmarrjes

- a) Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë, nuk duhet të jenë të operuar në toraks.
- b) Kanë të drejtë të pranohen edhe ata aplikantë të cilët:
 - i. kanë vuajtur nga TBC primar, por janë shëruar plotësisht;
 - ii. të sëmurët e shëruar plotësisht nga pneumonitë, bronkitet, pleuritet alergjike dhe azmatike,
 - iii. ata të cilët nuk kanë probleme pulmonare megjithë deformime minimale të gjoksit, të pranishme tek kandidati.

13. Kriteret neurologjike

Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe të mos jenë bartës të sëmundjeve neurologjike.

14. Kriteret psikiatrike

Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë mendor dhe të mos kenë pasur në asnjë rast sëmundje të kaluara psikike, të trashëguara apo të fituar vete apo nga familjarët e tyre.

15. Kriteret e ORL-së

- a. Aplikantët duhet të dëgjojnë nga të dy veshët pa ndihmën e pajisjeve për dëgjim deri në 10 Decibel për çdo vesh.
- b. Aplikantët duhet të jenë në gjendje të dallojnë tonë normale në largësitë 500, 1000, 2000 dhe 3000 frekuenca.
- c. Sinuset nazale duhet të jenë normal. Për këtë qëllim aplikantët bëjnë audiograme dhe radiografi të sinuseve.
- d. Aplikantët nuk duhet të jenë të operuar në pjesë të dukshme të fytyrës, veçanërisht në hundë, në vesh apo në qafë. Ata nuk duhet të kenë shenja të dallueshme të plagës, të mos jenë me mangësi dhe prishje të formës së tyre.
- e. Gjithashtu, aplikantët nuk duhet të kenë mangësi në folur.

16. Komisioni i Kontrollit Shëndetësor përbëhet nga 4 anëtarë. Kryetari i Komisionit Mjekësor është shefi i Sektorit të Profilaksisë-Mjekimit dhe 3 anëtarë mjekë të këtij sektori.

17. Komisioni shprehet për secilin kandidat, *“i aftë për tu pranuar në Policinë e Shtetit”* ose *“pa aftë për tu pranuar në Policinë e Shtetit”*.

18. Sektori i Profilaksisë-Mjekimit, në përfundim të kontrollit merr vendim bazuar në rezultatet e kontrollit shëndetësor të aplikantëve duke përcaktuar aplikantët të cilët janë të aftë për tu pranuar në Policinë e Shtetit si dhe aplikantët që nuk janë të aftë për tu pranuar në Policinë e Shtetit. Formulari i kontrollit shëndetësor behet pjese e dosjes së aplikantit.

19. Në Sektorin e Profilaksisë-Mjekimit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në spitalet shtetërore, bëhen ekzaminimet radiologjike dhe ato laboratorike si:

- a) Analizat e gjakut
- b) Analizat biokimike
- c) Antigen Hbs
- d) ECHO abdominal
- e) Urinë komplet ku përfshin urinë për drogë dhe urinë për alkool.
- f) Analiza HbA1c

20. Ekzaminimet laboratorike të veçanta që nuk kryen në laboratorin kliniko - biokimik të Sektorit

të Profilaksisë-Mjekimi, dërgohen për t'u kryer në laboratorë të shërbimit ambulator shtetëror.

21. Përfundimi i analizave duhet të jetë i saktë. Ato duhet të jenë të qarta në Raportin Mjekësor të lëshuar me këtë rast.
22. Aplikantët kryejnë vizitat mjekësore në prani të mjekëve të Sektorit të Profilaksi-Mjekimit. Shpenzimet e kontrollit mjekësor mbulohen nga aplikanti.
23. Për specialitetet që nuk mund të realizohen nga Sektori i Profilaksisë-Mjekimit, vizitat mjekësore realizohen në qendrat shëndetësore përkatëse sipas sistemit të referimit.

IX. TESTIMI ME SHKRIM

1. Testimi me shkrim për aplikantët që pranojnë rolin zbatues (arsimin e mesëm të lartë) vlerëson aftësitë e kandidatëve për të marrë vendime të arsyetuara dhe për të zgjidhur probleme në mënyrë logjike.

1.1. Synimet e testimit:

- a) Vlerësimi i arsytimit logjik dhe aftësisë për të marrë vendime të qarta.
 - b) Testimi i kuptimit të tekstit dhe aftësisë për analizimin e informacionit.
 - c) Vlerësimi i aftësive numerike dhe njohurive matematikore bazë.
 - d) Kontrolli i njohurive të përgjithshme mbi shtetin, shoqërinë dhe institucionet.
 - e) Vlerësimi i drejtshkrimit dhe përdorimit të saktë të gjuhës shqipe.
 - f) Identifikimi i kandidatëve me mendim të qartë, logjik dhe aftësi intelektuale të qëndrueshme, që përmbushin kriteret minimale për të vijuar me fazat e tjera të procesit të përzgjedhjes.
2. Testimi me shkrim i aftësisë profesionale për rolin e parë drejtues nga kategoritë e aplikantëve punonjës me statusin e Policisë Gjyqësore dhe Punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë vlerëson njohuritë dhe aftësive profesionale të kandidatëve.

2.1. Fushat e testimit:

- a) Legjislacioni penal dhe procedura penale.
 - b) Organizimi dhe funksionimi i Policisë së Shtetit.
 - c) Përdorimi i drejtshkrimit zyrtar dhe terminologjisë juridike për përgatitjen e teksteve dhe dokumenteve standarde të punës.
 - d) Drejtshkrim zyrtar dhe terminologji juridike e saktë.
3. Koha dhe vendi i zhvillimit të testit me shkrim, ankimimit, si dhe kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit me shkrim, përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Pyetjet e testit me shkrim hartohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, **Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, si dhe** Komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me strukturat vendore të policisë ku janë regjistruar aplikantët, bëjnë njoftimin e secilit aplikant për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të testimit si **dhe numrin kodik**.
6. Rezultatet e testimit të afishohen menjëherë pas përfundimit të korigjimit të testit si dhe publikohen nga **Akademia e Sigurisë** dhe në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit nga **Sektori i Marrëdhënieve me Median dhe Publikun**, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
7. Në procesin e testimit me shkrim ndiqen këto rregulla:
 - a) Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë cakton mbikëqyrësit, regjistruarit, orientuesit. Numri i punonjësve është në vartësi të numrit të aplikantëve si dhe ambienteve ku zhvillohet testimi.
 - b) Para fillimit të regjistrimit, aplikantët qëndrojnë jashtë dhe futen me radhë, sipas orientimeve që jepen nga personat e përcaktuar për këtë qëllim.
 - c) Aplikantët orientohen në bazë të kodit, të shkojnë të regjistrohen pranë tavolinës ku janë listat me emrat, mbiemrat dhe kodin e aplikimit.
 - d) Aplikanti duhet të paraqitet patjetër me fletën e pranimit dhe dokument identifikimi (letër njoftim, pasaportë biometrike, ose leje drejtimi) në testimin me shkrim dhe pasi të verifikohet nga ana e regjistruarit, bëhet regjistrimi i tij.
 - e) Në këtë rast aplikanti nënshkruan në listën që ka regjistruarit duke konfirmuar pjesëmarrjen e tij.
 - f) Fleta e pranimit në testimin me shkrim kontrollohet nga regjistruarit nëse ka firmën e shefit të Burimeve Njerëzore dhe vulën e sekretarisë së DVP përkatëse, si dhe foton e vetë aplikantit.
 - g) Aplikanti që nuk ka fletën e pranimit dhe dokumenti identifikimi në testin me shkrim, nuk regjistrohet.
 - h) Fleta e pranimit në testimin me shkrim i jepet përsëri aplikantit, të cilën e përdor edhe në testet e tjera, nëse është fitues.
 - i) Aplikantët orientohen të hyjnë dhe të ulen në sallë nga punonjësit e caktuar me shërbim për këtë qëllim.
 - j) Në sallë nuk lejohet të hyjë asnjë person tjetër, përveç aplikantëve dhe mbikëqyrësve të procesit.
 - k) Me të përfunduar regjistrimi, nuk lejohet hyrja e askujt në sallë, mbyllet salla dhe fillon dhënia e udhëzimeve.
 - l) Mbikëqyrësit pasi marrin nga Komisioni testin, fletën e skantronit, lapsat dhe fleta të bardha, ju a shpërndajnë konkurrentëve.
 - m) Konkurrentët nuk kryejnë asnjë veprim me testin, deri sa të fillojë koha për të gjithë njëkohësisht.
 - n) Gjatë kohës që vazhdon testimi, konkurrentët njoftohen disa herë për kohën e mbetur në dispozicion.

- o) Aplikantët që mbarojnë më herët se koha në dispozicion, duhet të dorëzojnë testin, fletën e skantronit dhe materialet e testimit dhe të dalin jashtë sallës.
- p) Me përfundimin e orarit mblidhen testet, fletët e skantronit dhe bazat materiale dhe dorëzohen pranë Komisionit të Korrigjimit të Testit përkundrejt proces-verbalit.
- q) Gjatë korrigjimit të testit, duhet të jenë të pranishëm një numër prej 5-10 konkurrentësh.
- r) Me të përfunduar korrigjimi, printohen listat me pikët në rend zbritës dhe afishohen për njoftimin e konkurrentëve.
- s) Konkurrentët që kanë arritur jo më pak se kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit me shkrim, të vendosur në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kanë të drejtë të vazhdojnë fazat e tjera të procesit të konkurrimit.
- t) Kandidatëve nuk u lejohet mbajtja e makinave llogaritëse si dhe pasje elektronike gjatë zhvillimit të testimit”, si:

- i. Fotografimi i testit dhe shpërndarja e tij në rrjetet sociale,
- ii. Dërgimi i testit personave të tjerë gjatë zhvillimit të testit,
- iii. Përdorimi i kufjeve profesionale për zgjidhjen e testit nga persona të tjerë.


X. TESTIMI FIZIK

1. Testi i aftësive fizike mat aftësitë psikomotore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësitë fizike, koordinimi fizik etj.
2. Para zhvillimit të testimit të aftësive fizike, konkurrentët duhet t’i nënshtrohen kontrollit mjekësor duke bërë vetë deklarin mbi gjendjen shëndetësore dhe me pas verifikimit të gjatësisë dhe moshës, si kritere kualifikuese në procesin e testimit.
3. Në procesin e testit të aftësive fizike ndiqen këto rregulla:
 - a) Akademia e Sigurisë vendosë tabela orientuese që t’i drejtojnë konkurrentët në ambientin ku zhvillohet testimi.
 - b) Konkurrentët paraqiten me fletën e pranimit dhe dokumentin e identifikimit tek regjistruesi i cili bën verifikimin dhe më pas regjistron konkurrentin.
 - c) Konkurrentët e regjistruar grupohen sipas mundësive dhe shoqërohen nga orientuesit për tek Komisioni i Vlerësimit të Aftësive Fizike, për t’ju nënshtuar testimit.
 - d) Para zhvillimit të testit nga Komisioni jepen udhëzime për të gjithë komponentët e testimit fizik duke i demonstruar me veprime konkrete.
 - e) Sigurohen që konkurrenti i kupton veprimet që duhet të kryejë.
 - f) Vëzhgohet konkurrenti gjatë gjithë testit.
 - g) Në fletën e testit që plotësohet nga Komisioni për çdo kandidat shënohen pikët dhe në bazë të rezultatit përfundimtarë bëhet shënimi “Kalon” ose “Ngel”.

h) Njoftohen kandidatët për rezultatin, përkundrejt nënshkrimit nga ana e tyre.

4. Në testin fizik, aplikantët i nënshtrohen testeve si kërcim nga vendi dhe cirkuidit.
5. Pas regjistrimit, kontrollit shëndetësor si dhe matjeve për plotësimin e kritereve, aplikanti kalon në zhvillimin e testimit i cili fillon me kërcim nga vendi.

A. KËRCIM NGA VENDI



- a. Kërcimi nga vendi është një test i thjeshtë dhe efektiv për të matur disa aftësi fizike të aplikantit, veçanërisht forcën dhe fuqinë e këmbëve. Ky test vlerëson kryesisht:
 - i. Forcën e muskujve të këmbëve
 - ii. Fuqinë eksplozive;
 - iii. Koordinimin dhe kontrollin motorik;
 - iv. Balancën dhe stabilitetin;
 - v. Elasticitetin muskular dhe tendinor;
- b. Ky test kryhet brenda një kuadrati me gjatësi 4 m dhe gjerësi 3 m. Përmasat e këtij kuadrati nuk janë detyruese por e rëndësishme është që vendi i kryerjes së testit të krijojë mundësi optimale për arritjen e rezulttit maksimal nga konkurruesi.
- c. Në kryerjen e këtij testi konkurruesi vendos këmbët mbi vijën përkatëse të nisjes (kërcimit). Në mënyrë të lirë ai kërcen me të dyja këmbët nga vendi duke synuar një distancë sa më të largët. Vendosja e këmbëve bëhet pa e kaluar vijën kufizuese dhe matja e distancës kryhet nga vendi i kërcimit (vija) deri në pikën më të afërt nga kjo vijë që shkel konkurruesi, sipas skicës përkatëse.
- d. Çdo konkurrues ka të drejtën e dy provave radhazi dhe në vlerësimin përfundimtar i shënohet rezultati më i mirë nga dy provat.

- e. Pas përfundimit të testimit “Kërcim nga vendi”. Aplikanti lihet për 5 -10 minuta dhe pastaj fillon testin “Cirkuid”.
- f. Testi është i njëjtë për meshkuj dhe femra, por vlerësimi me pikë ndryshon sipas tabelës përkatëse të pikëzimit:

MESHKUJ Moshë 18-35 vjeç		FEMRA Moshë 18-35 vjeç	
Rezultati në cm	Pikë	Rezultati në cm	Pikë
250	20	220	20
245	19	210	19
240	18	200	18
235	17	195	17
230	16	190	16
225	15	185	15
220	14	180	14
215	13	175	13
210	12	170	12
205	11	165	11
200	10	160	10
195	9	155	9
190	8	150	8
185	7	145	7
180	6	140	6
175	5	135	5
170	4	130	4
165	3	125	3
160	2	120	2
155	1	115	1
<155	0	115	0

MESHKUJ Moshë 36-45 vjeç		FEMRA Moshë 36-45 vjeç	REZULTATI
Rezultati në cm	Pikë	Rezultati në cm	Pikë
230	20	200	20
225	19	195	19
220	18	190	18
215	17	185	17
210	16	180	16
205	15	175	15
200	14	170	14
195	13	165	13
190	12	160	12

185	11	155	11
180	10	150	10
175	9	145	9
170	8	140	8
165	7	135	7
160	6	130	6
155	5	125	5
150	4	120	4
145	3	115	3
140	2	110	2
135	1	105	1
<135	0	<105	0

Meshkuj Moshë 46-55 vjeç		Femra Moshë 46-55 vjeç	
Rezultati në cm	Pikë	Rezultati në cm	Pikë
210	20	180	20
205	19	175	19
200	18	170	18
195	17	165	17
190	16	160	16
185	15	155	15
180	14	150	14
175	13	145	13
170	12	140	12
165	11	135	11
160	10	130	10
155	9	125	9
150	8	120	8
145	7	115	7
140	6	110	6
135	5	105	5
130	4	100	4
125	3	95	3
120	2	90	2
115	1	85	1
<115	0	<85	0

Rezultati i kërcimit nga vendi përbën 20% të vlerësimit të përgjithshëm të testit fizik.


B. CIRKUIDI

1. Cirkuidi është një seri ushtrimesh të ndryshme që kryhen njëra pas tjetrës pa pushim. Ky test është shumë efektiv për të matur disa aftësi fizike dhe karakteristika të performancës, si:

- a. Forcën muskulare;
- b. Rezistencën kardiovaskulare;
- c. Fuqinë eksplozive;
- d. Shpejtësinë dhe agilitetin (shpejtësinë dhe aftësia për te ndryshuar drejtimin ne mënyrë efektive)
- e. koordinimin dhe kontrollin motorik;
- f. Balancën dhe stabilitetin;
- g. Fleksibilitetin dhe lëvizshmërinë;
- h. Dukshmërinë anaerobe. (aftësinë për te kryer pune me intensitet te larte për periudha te shkurtra kohore)

2. Për femrat, cirkuidi përfshin 6 segmente (stacione):


- a. Vrapim 2 x 10 m, me 1 vajtje ardhje me rrotullim pas koneve (piramida, flamur, etj.), përkatëse.
- b. Vrapim sllallom ndërmjet 6 koneve (piramida, flamur etj.), të vendosura 2.5 m larg njëra – tjetrës dhe rrotullim pas konit përballë.
- c. Kapërcim mbi piketa, me ngritje gjunjësh në formë “skip”, 6 piketa në distancë 80 cm larg njëra – tjetrës.
- d. Vrapim 2 x 10 m, me rrotullim pas konit përkatës.
- e. Rrotullim pas konit përkatës, vrull, kapërdimje para.
- f. Kalim i lirë i 5 pengesave (të atletikës) të vendosura 3 m larg njëra- tjetrës;



3. Për meshkujt, cirkuidi përfshin 7 segmente (stacione):

- a. Vrapim 2 x 10 m, me 1 vajtje ardhje me rrotullim pas koneve (piramida, flamur, etj.), përkatëse.

- b. Vrapim sllallom ndërmjet 6 koneve (piramida, flamur etj.), të vendosura 2.5 m larg njëra – tjetrës dhe rrotullim pas konit përballë.
- c. Kapërcim mbi piketa, me ngritje gjunjësh në formë “skip”, 6 piketa në distancë 80 cm larg njëra – tjetrës.
- d. Kalimin e 3 pengesave në forme të shkallëzuar (në distancë 5.5 m) me të dyja këmbët;
- e. Vrapim 2 x 10 m, me rrotullim pas konit përkatës.
- f. Rrotullim pas konit përkatës, vrull, kapërdimje para.
- g. Kalim i lirë i 5 pengesave (të atletikës) të vendosura 3 m larg njëra- tjetrës;



Rezultati i cirkudit përbën 80% të vlerësimit të përgjithshëm të testit fizik.

Kandidati nisjet në vendin ku shënohet “Nisja” dhe vazhdon garën sipas segmenteve të përcaktuara me sipër. Matja e kohës me kronometër fillon në momentin e dhënies së sinjalit për nisje në pikën e nisjes së cirkudit. Matja e kohës behet me dy kronometra duke marrë kohën mesatare të të dy matjeve. Në momentin që konkurruesi kalon vijën ku shënohet “Mbërritja” shtypet kronometri dhe përcaktohet koha e testit e cila korrespondon me pikët përkatëse të përcaktuara në tabelë.

Nr.	Për meshkujt Moshë 18-35 vjeç Koha në sekonda	Për femrat Moshë 18-35 vjeç Koha në sekonda	Rezultati në Pikë
1.	42	55	80
2.	43 - 45	56 - 58	75
3.	46 - 48	59 - 61	70

Nr.	Për meshkujt Mosha 18-35 vjeç Koha në sekonda	Për femrat Mosha 18-35 vjeç Koha në sekonda	Rezultati në Pikë
4.	49 - 51	62 - 64	65
5.	52 - 54	65 - 67	60
6.	55 - 57	68 - 70	55
7.	58 - 60	71 - 73	50
8.	61 - 63	74 - 76	45
9.	64 - 66	77 - 79	40
10.	67 - 70	80 - 82	35
11.	71 - 74	83 - 85	30
12.	75	86	0

Nr.	Për meshkujt Mosha 36-45 vjeç Koha në sekonda	Për femrat Mosha 36-45 vjeç Koha në sekonda	Rezultati në Pikë
1.	45	58	80
2.	46 - 48	59 - 61	75
3.	49 - 51	62 - 64	70
4.	52 - 53	65 - 67	65
5.	54 - 56	68 - 70	60
6.	57 - 59	71 - 73	55
7.	60 - 62	74 - 76	50
8.	63 - 65	77 - 79	45
9.	66 - 69	80 - 82	40
10.	70 - 72	83 - 85	35
11.	73 - 75	86 - 88	30
12.	80	90	0

Nr.	Për meshkujt Mosha 46-55 vjeç Koha në sekonda	Për femrat Mosha 46-55 vjeç Koha në sekonda	Rezultati në pikë
1.	48	60	80

Nr.	Për meshkujt Mosha 46-55 vjeç Koha në sekonda	Për femrat Mosha 46-55 vjeç Koha në sekonda	Rezultati në pikë
2.	49 - 51	61 – 63	75
3.	52 – 54	64 -66	70
4.	55 -57	67 - 69	65
5.	58 – 60	70 - 72	60
6.	61 – 63	73 - 75	55
7.	64 – 66	76 - 78	50
8.	67 – 69	79 - 81	45
9.	70 – 72	82 - 85	40
10.	73 – 75	86 - 88	35
11.	77 – 79	89 - 91	30
12.	85	95	0

Aplikantët të cilët nuk kryejnë si duhet circuitin sipas stacioneve, ndëshkohen me penalitete duke iu ulur pikë për secilin stacion e konkretisht:

- Në stacionin e parë**, është detyruar rrotullimi pas koneve. Në rast të kundërt për arsye të shkurtimit të distancës konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë.
- Në stacionin e dytë**, është detyruar të kalohen të 6 konet. Rrotullimi mbas konit përballë për të kaluar të kërcimi i piketave është detyruar. Në rast të kundërt për arsye të kalimit jo korrekt të distancës, konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë.
- Në stacionin e tretë**, kapërcimi i 6 piketave me gjuhët e lart në formë “skip”, është detyruar. Në rast të kundërt konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë.
- Në stacionin e katërt**: Kalimin e 3 pengesave në forme të shkallëzuar (në distance 5.5 m) me të dyja këmbët. Në rast të kundërt konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë;
- Në stacionin e pestë**: Për kapërcimit të piketave, rrotullimi pas koneve për të kryer vrapimin 10 m dhe kthimi është detyruar. Në rast të kundërt për shkurtim distance, konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë.
- Në stacionin e gjashtë**: Rrotullimi pas konit, para kapërdimjes është detyruar. Në të kundërt për ekzekutim jo korrekt ose për mos kryerjen e kapërdimjes para, konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë.
- Në stacionin e shtatë**: Kapërcimi i 5 pengesave të (atletikës) është detyruar. Rrëzimi i pengesës pas kapërcimit të saj nuk përbën shkelje dhe nuk ndëshkohet. Mos kapërcimi i pengesës, për çdo pengesë që nuk kapërcehet, konkurruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë. Mos kapërcimi i 5 pengesave ndëshkohet me minus 25 (njëzet e pesë) pikë.

Në rast se në stacionin e shtatë për meshkujt dhe në stacionin e 6 për femrat, aplikanti nuk kalon pengesat duke ju shmangur atyre, ai s'kualifikohet dhe merr 0 (zero) pikë.

XI.INTERVISTA ME GOJE

Konkurrentët gjatë intervistës me gojë testohen në lidhje me njohuritë, aftësitë e kandidatit për të menduar, analizuar, komunikuar dhe marrë vendime. Aplikantët të cilët në mënyrë të dukshme, kanë vështirësi në shprehje dhe komunikim, s'kualifikohen nga Komisioni me vendim të arsyetuar.

Intervista me gojë synon të vlerësojë:

- a. Aftësitë e kandidatit për të menduar, analizuar, komunikuar dhe marrë vendime;
- b. Aftësitë e kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;
- c. Përshtatshmërinë e kandidatit për tu bërë punonjës policie.

Për zhvillimin e intervistës me gojë ndiqen këto rregulla:

1. Para fillimit të intervistës bëhet sistemimi i ambienteve ku zhvillohet intervista.
2. Grupi i regjistrimit bën regjistrimin e kandidatëve që paraqiten në intervistë.
3. Kandidati në momentin e regjistrimit duhet të ketë me vete dokumentin e identifikimit
4. Pyetjet intervista me gojë hartohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor në bashkëpunim me Komisionin e Pranimit/ Vlerësimit, duke shfrytëzuar bankën e pyetjeve.
5. Pyetjet nuk kërkojnë njohuri paraprake të teknikave të policisë, por përqendrohen në aftësinë e aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar dhe vendosur.
6. Aplikanti del përpara komisionit dhe përgjigjet një radhë pyetjesh të strukturuar, si dhe pyetjeve të përshtatshme vijuese, të hartuara për të përmbushur qëllimet e intervistës.
7. Në intervistën me gojë, aplikantit i bëhen tre pyetje.
8. Rezultati nga anëtarët e komisionit vendosen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.
9. Për secilën pyetje vlerësimi është nga 1-10 pikë.
10. Në qoftëse ndryshon niveli i vlerësimit me nga tre pikë, secili anëtar argumenton me shkrim.
11. Me të mbaruar intervistën, kandidati largohet nga salla.
12. Personeli ndihmës merr pyetjet e vlerësuara dhe i dërgon tek regjistruesit. Grupi i regjistrimit përllorarit pikët për secilin kandidat, në bazë të një mekanizmi të miratuar vlerësimi.

XII. TESTI PSIKOLOGJIK

a. Testimi psikologjik

Synon të vlerësojë nëse aplikanti zotëron këto aftësi të domosdoshme për ushtrimin e detyrës policore:

- i.Stabilitet emocional dhe vetëkontroll.
- ii.Përshtatshmëri për detyrën.
- iii.Aftësi për të menaxhuar stresin dhe presionin.
- iv.Integritet personal dhe etik.

b. Testimi zhvillohet duke respektuar parimet:

- i.Objektivitet dhe paanshmëri.
- ii.Profesionalizëm dhe pavarësi në vlerësim.
- iii.Barazi në trajtim të aplikantëve.
- iv.Vendimmarrje e bazuar në analiza profesionale.
- v.Konfidencialitet të të dhënave.

c. Përmbajtja e testimit psikologjik

- i.Testimi përfshin instrumente të shkruara, vizuale dhe verbale të administruara nga psikologë të kualifikuar.
- ii.Kryhet intervistë individuale ballë për ballë me komisionin.
- iii.Përdoren pyetje të hapura, të mbyllura, teste të vetë–raportimit dhe skenarë (kazuse).

d. Aplikanti që vlerësohet “kalues” duhet të demonstrojë:

- i.Arsyetim të qartë dhe logjik.
- ii.Artikulim verbal të saktë dhe komunikim të qëndrueshëm jo–verbal.
- iii.Kontroll emocional dhe etikë në situata tensioni, konflikti apo provokimi.

e. Kriteret e vlerësimit – “Jo kalues”

- i.Aplikanti vlerësohet jo kalues kur komisioni evidenton:
- ii.Mungesë stabiliteti emocional dhe të menaxhimit të impulsivitetit.
- iii.Vështirësi të theksuara në menaxhimin e stresit dhe presionit.
- iv.Mungesë integriteti dhe etike.
- v.Çrregullime psikiatrike akute ose të pakompensuara.
- vi.Çrregullime të personalitetit.
- vii.Varësi ose abuzim me substanca psikotrope apo alkool.
- viii.Paqëndrueshmëri në komunikimin jo verbal.
- ix.Papjekuri emocionale (ndryshime të forta të humorit).

f. Për çdo aplikant përpilohet:

- i.Procesverbal i testimit.
- ii.Formulari i vlerësimit psikologjik (Lidhja nr. 1).
- iii.Për aplikantët “jo kalues” hartohet vendimi i posaçëm i komisionit (Lidhja nr. 2).

g. Vlerësimi në testin psikologjik, bëhet nga psikologë të licencuar pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit ose psikologë të autorizuar për këtë fazë të testimit, për qëllimin e përzgjedhjes së aplikantëve.

XIII. VERIFIKIMI I BESUESHMERISË APLIKANTËVE

1. Procesi i verifikimit të aplikantëve fillon nominalisht për secilin aplikant, menjëherë pas shqyrtimit të dokumentacionit të tij. Ai kryhet vetëm për aplikantët të cilët plotësojnë kriteret ligjore si dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të aplikimit.
2. Strukturat e burimeve njerëzore ku kryhet aplikimi, në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit hartojnë listën e aplikantëve dhe e dërgojnë atë pranë Drejtorive/ Komisariateve Vendore të Policisë ku aplikanti ka vendbanimin, të cilat hartojnë vërtetimin e besueshmërisë, si dhe administrojnë për krahasim pranë Sektorëve të Policisë Shkencore gjurmët daktiloskopike të aplikantëve. Nëse aplikimi kryhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, administrimi i gjurmëve daktiloskopike behet nga Instituti i Policisë Shkencore në komunikim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
3. Verifikimi i besueshmërisë së aplikantëve është një proces i verifikimit të të dhënave të vetë deklaruara nga ata në raport me ato të regjistrave fizike dhe elektronik të administruara nga Policia e Shtetit dhe Institucionet e tjera shtetërore shqiptare apo të huaja.
4. Verifikimi i besueshmërisë së aplikantëve behet në baze të rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Procedurën standarde “Rastet, modalitetet dhe strukturat që hartojnë vërtetimin e besueshmërisë”, të miratuara me urdhër nr. 17 datë 10.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
5. Kandidatët që përfundojnë me sukses programin e formimit bazë policor, të cilë pranohen në strukturat e Policisë së Shtetit, pas marrjes së grades, i nënshtrohen procedurave për marrjen e gjurmëve daktiloskopike nga drejtoritë vendore të policisë, ku kanë bërë aplikimin.
6. Marrja e gjurmëve daktiloskopike, bëhet sipas procedurave standarde, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
7. Instituti i Policisë Shkencore bën krahasimin e gjurmëve daktiloskopike dhe dërgon informacion me shkrim pranë strukturave të burimeve njerëzore, ku është kryer aplikimi, brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
8. Aplikantët që pas krahasimit të gjurmëve daktiloskopike rezultojnë me problem dhe figurojnë të regjistruar në kartotekën e Policisë Shkencore, i nënshtrohen procedurave të mëtejshme të verifikimit dhe kontrollit nga strukturat e hetimit të krimeve ku janë evidentuar gjurmët apo aplikanti ka vendbanimin e tij.

XIV. RASTET E SKUALIFIKIMIT

1. Aplikanti skualifikohet në rastet e përcaktuara në udhëzimet në fuqi të Ministrit të Punëve të Brendshme për pranimet në rolin zbatues dhe në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit.

2. Aplikanti skualifikohet dhe procesi i konkurrimit ndërpritet në çdo fazë të tij kur konstatohet se kandidati:
 - a) Nuk ka aplikuar brenda afatit të përcaktuar në shpalljen e aplikimeve;
 - b) Nuk ka dorëzuar, në momentin e aplikimit, dokumentacionin e detyrueshëm sipas kërkesave;
 - c) Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe/ose kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen përkatëse;
 - d) Ka deklaruar të dhëna të rreme ose ka paraqitur dokumente të falsifikuara;
 - e) Është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - f) Rezulton përdorues i lëndëve narkotike;
 - g) Rezulton me varësi nga alkooli;
 - h) Nuk kalon kontrollin shëndetësor sipas standardeve mjekësore në fuqi;
 - i) Nuk plotëson kriterin e besueshmërisë dhe/ose kriterin e sigurisë për pajisjen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit”;
 - j) Nuk paraqitet në kohën dhe vendin e përcaktuar për cilëndo prej fazave të testimit;
 - k) Nuk vlerësohet me të paktën 50% të pikëve të mundshme në secilën fazë të testimit;
 - l) Ndërpret testimin ose përjashtohet prej tij për shkak të shkeljeve proceduriale, përfshirë: kopjimin, komunikimin me kandidatë të tjerë, ndërrimin e variantit të testit, përdorimin e pajisjeve elektronike, makinerive llogaritëse apo mjeteve të tjera të ndaluara.

XV. ANKIMIMI

1. Çdo aplikant ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditësh nga momenti i njoftimit me email, pranë Komisionit të shqyrtimit të ankesave, përbërja e të cilit përcaktohet në momentin e shpalljes së fazës së aplikimeve.
2. Ankimimi mund të behet nëpërmjet emailit në adresën e publikuar në momentin e shpalljes së aplikimeve ose pranë strukturës ku është bere aplikimi. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave njofton aplikantin brenda 3 dite pune në lidhje me vendimin e marre. Çdo njoftim me email në rastet e kualifikimeve, skualifikimeve apo vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave behet pjese e dosjes së procesit të pranimit të krijuar nga strukturat e Burimeve Njerëzore.
3. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nëse aplikantët plotësojnë apo jo kriteret dhe do të bëhen pjese e procesit të pranimit, në çdo rast fillon menjëherë në momentin e dorëzimit të dokumentacionit nga aplikantët.
4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ngrihet në nivel vendor pranë strukturës ku kryhet aplikimi si dhe në nivel qendror pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

a) në nivel vendor, Komisioni përbehet nga:

- i. *Zëvendës titullari;*
- ii. *Shef/Specialist i Burimeve Njerëzore;*
- iii. *Përfaqësuesi Juridik strukturës;*

b) Në nivel qendror, Komisioni përbehet nga:

- i. *Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;*
- ii. *Drejtori i Standardeve Profesionale*
- iii. *Drejtori i Burimeve Njerëzore*

5. Komisioni asistohet nga Sekretaria e Teknikës, e cila ofron mbështetjen administrative e teknike Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
6. Komisionet në nivel vendor shqyrtojnë rastet e skualifikimeve në fazën e aplikimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën IV/1/a të kësaj procedure.
7. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave merr vendim me shumicë të thjeshtë votash.
8. Aplikantët njoftohen me emal mbi vendimin e Komisionit të ankimimit brenda 2 ditësh nga data e marrjes së vendimit.

XVI. SHPALLJA E REZULTATEVE

1. Në përfundim të procesit të ankimimit, Komisionet e vlerësimit sipas kategorisë së pranimit shpallin listën e aplikantëve fitues. Rezultati përfundimtar përlogaritet me dy presje dhjetore.
2. Nëse ka aplikantë me pike të barabarta, renditet me lart aplikanti i cili ka vlerësimin më të lartë në testimin sipas peshës specifike me të lartë në raport me rezultatin e përgjithshëm. Nëse përsëri rezultati mbetet i njëjtë, vazhdohet me testimin e radhës sipas rendit zbritës me peshe specifike me të lartë.

XVII. DOKUMENTIMI DHE ARKIVIMI NË PROCESIN E PRANIMIT

1. Dispozita të Përgjithshme

- 1.1. Dokumentimi dhe arkivimi i çdo dokumenti, informacioni ose materiali të prodhuar gjatë procesit të pranimit kryhen në përputhje të plotë me standardet administrative të Policisë së Shtetit, legjislacionin përkatës, rregulloret institucionale për menaxhimin e dokumenteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me praktikën më të mirë të administratës publike.
- 1.2. Çdo veprim i kryer gjatë procesit të pranimit duhet të jetë i dokumentuar qartë, i verifikueshëm, i plotë, i saktë dhe i gjurmueshëm, në mënyrë që të mundësohet auditimi i çdo faze të procedurës nga organet e brendshme dhe të jashtme të Policisë së Shtetit.

1.3. Dokumentet dhe informacionet e mbledhura përdoren ekskluzivisht për qëllime institucionale të lidhura me procesin e pranimit. Çdo shpërndarje ose akses nga persona, struktura ose institucione të paautorizuara konsiderohet shkelje e rregullave të Policisë së Shtetit dhe legjislacionit në fuqi.

2. Dokumentimi gjatë Faza të Procesit të Pranimit

2.1. Faza e Aplikimit

- a) Çdo dokument i dorëzuar nga aplikanti regjistrohet me datë, orë dhe nënshkrimin e personit përgjegjës;
- b) Plotësia e dosjes së aplikantit verifikohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, strukturat vendore të burimeve njerëzore dhe çdo mungesë shënohet në mënyrë formale;
- c) Çdo aplikant i caktohet një numër kodi identifikimi (ID) për gjurmueshmëri elektronike dhe fizike;
- d) Dokumentet regjistrohen në sistemin elektronik të menaxhimit të dokumenteve, duke ruajtur të dhënat në formë të kriptuar dhe të auditueshme.

2.2. Faza e Verifikimeve

- a) Çdo veprim administrativ ose verifikues regjistrohet në formë shënimi zyrtar ose procesverbal;
- b) Personi përgjegjës për verifikimin firmos çdo dokument dhe e protokollon sipas rregullave të klasifikimit;
- c) Çdo kërkesë për informacion nga strukturat e tjera institucionale regjistrohet dhe bashkëngjitet në dosjen e aplikantit;
- d) Raportet e verifikimit administrativ dhe të integritetit dokumentohen me referenca specifike dhe datë, duke garantuar transparencë dhe gjurmueshmëri.

2.3. Faza e Testimeve dhe Vlerësimit

- a) Listat e pjesëmarrësve në testimet me shkrim, fizike, psikologjike, intervistë me gojë dhe profesionale hartohen dhe regjistrohen me datë dhe orë;
- b) Komisionet hartojnë procesverbalet e vlerësimit për secilin aplikant, duke përfshirë rezultate të detajuara dhe shënime objektive;
- c) Të gjithë anëtarët e komisionit firmosin dokumentacionin përkatës, duke siguruar përgjegjësi individuale dhe kolektive;
- d) Çdo dokument i gjeneruar gjatë testimeve lidhet me dosjen individuale të aplikantit dhe ruhet në sistemin elektronik dhe fizik.

2.4. Faza e Vendimmarrjes

- a) Vendimi përfundimtar dokumentohet me akt administrativ të argumentuar, duke përfshirë bazën ligjore, kriteret e vlerësimit dhe rezultatet e testimeve;
- b) Akti shoqërohet me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe bëhet pjesë integrale e dosjes së aplikantit;

- c) Çdo njoftim zyrtar i vendimit, përfshirë miratimin ose refuzimin, regjistrohet dhe arkivohet sipas procedurave institucionale.

3. Llojet e Dokumenteve që i Nënshtrohen Dokumentimit dhe Arkivimit

3.1. Dokumentet që i nënshtrohen dokumentimit dhe arkivimit përfshijnë, pa u kufizuar në:

- a) Formularët e aplikimit dhe deklaratimet shoqëruese, përfshirë deklaratimet për të dhënat personale, integritetin dhe përputhshmërinë me kriteret e punës;
- b) Dokumentet e identifikimit personal, aktet civile (çertifikata lindjeje, etj) dhe dokumentet arsimore dhe profesionale;
- c) Raportet e verifikimit administrativ dhe kontrollit të integritetit, duke përfshirë vërtetimin e besueshmerisë, dhe agjencive të tjera ligjzbatuese;
- d) Rezultatet e testeve me shkrim, fizike, psikologjike, profesionale, interviste me gojë dhe vlerësimin administrativ;
- e) Procesverbalet e komisioneve të vlerësimit, raportet përmbledhëse dhe aktet përfundimtare të vlerësimit;
- f) Vendimet administrative për miratimin ose refuzimin e aplikantëve të komisionit të pranimit dhe apelimit;
- g) Korrespondenca zyrtare me aplikantët, përfshirë njoftimet, thirrjet dhe informacionin mbi fazat e procesit;
- h) Ankesat, kërkesat për rivlerësim dhe dokumentet shoqëruese që lidhen me to.

3.2. Çdo dokument konsiderohet pjesë integrale e dosjes individuale të aplikantit dhe duhet të arkivohet sipas standardeve të klasifikimit dhe kodifikimit të miratuara nga Policia e Shtetit, duke garantuar identifikueshmëri dhe gjurmueshmëri unike.

4. Arkivimi i Dokumenteve

4.1. Arkivimi Fizik

- a) Dokumentet vendosen në dosje individuale sipas sistemit të klasifikimit të miratuar;
- b) Dosjet ruhen në hapësira të sigurta, të mbyllura dhe të monitoruara, të mbrojtura nga akseset e paautorizuara, zjarri, ujërat, dëmtimi fizik ose humbja;
- c) Çdo lëvizje e dosjes regjistrohet në regjistrin e arkivit, duke përfshirë personin që merr dosjen, qëllimin dhe kohëzgjatjen e përdorimit.

4.2. Arkivimi Elektronik

- a) Dokumentet digjitalizohen dhe ngarkohen në sistemin elektronik të menaxhimit të dokumenteve;
- b) Sistemi elektronik garanton kriptim të të dhënave, kontrolle të qarta të aksesit sipas niveleve të autorizimit dhe regjistrim të veprimeve (audit log) për çdo veprim;
- c) Bëhet kopje rezervë periodike e të dhënave dhe restaurimi i tyre sigurohet në rast humbjeje ose dëmtimi;
- d) Sistemi elektronik është në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë së informacionit.

4.3. Afatet e Ruajtjes dhe Asgjësimi

- a) Dokumentet ruhen për periudha të përcaktuara sipas rregullave arkivore të Policisë së Shtetit, duke respektuar ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) Pas përfundimit të afatit të ruajtjes, dokumentet asgjësohen sipas procedurave të miratuara, duke garantuar që nuk ka mundësi rikuperimi të të dhënave;
- c) Çdo asgjësim i dokumenteve fizike dhe elektronikë dokumentohet dhe protokollohet.

5. Përdorimi i Dokumentacionit të Arkivuar

5.1. Dokumentet e arkivuara përdoren ekskluzivisht për qëllimet institucionale të Policisë së Shtetit dhe vetëm nga punonjësit e autorizuar, duke përfshirë:

- a) Shqyrtimin e ankimeve të aplikantëve ose kërkesave për rivlerësim;
- b) Auditimet e brendshme dhe të jashtme për verifikimin e zbatimit të procedurave të pranimit;
- c) Kontrollin dhe verifikimin e mëvonshëm të integritetit, të dhënave personale dhe të të dhënave të dokumentacionit të aplikantit;
- d) Monitorimin e zbatimit të standardeve administrative dhe të politikave institucionale;
- e) Mbështetjen e vendimeve të reja administrative që kërkojnë referencë historike të dokumenteve të procesit të pranimit.

5.2. Çdo përdorim i dokumenteve duhet të dokumentohet dhe të regjistrohet në mënyrë të detajuar, duke përfshirë:

- a) Emrin dhe pozicionin e personit që ka kërkuar qasje;
- b) Qëllimin për të cilin kërkohet qasja;
- c) Data dhe ora e qasjes;
- d) Çdo veprim të kryer mbi dokumentet, përfshirë kopjimin, referencimin ose transferimin.

5.3. Dokumentet nuk mund të nxirren jashtë hapësirave të autorizuara fizike ose elektronike, përveç rasteve të parashikuara me akt ligjor ose urdhër të zyrtarëve të autorizuar të Policisë së Shtetit.

5.4. Ndërhyrjet, ndryshimet ose shtesat në dokumentet e arkivuara janë të ndaluara dhe çdo shkelje trajtohet si shkelje disiplinore dhe ligjore.

